

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Filologjisë
Dega: Gjuhë dhe Letërsi angleze

Lënda: Gjuhë e sotme shqipe 2

Lëndë obliguese. Niveli bachelor “Hasan Prishtina”

Viti I i studimeve; Semestri II

Numri i orëve në javë: 2 + 2

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Mësimdhënësja e kursit: Prof. Ass. Dr. Flutura Çitaku

Qëllimet e kursit: Përmes lëndës “Gjuhë e sotme shqipe 2” studentët do të kenë mundësinë të përvetësojnë strukturën sintaksore të gjuhës së sotme shqipe. Në orët e ligjëratave do të shpjegohen, fjalia, tipat e fjalive, përbërësit e fjalisë dhe funksionet e tyre sintaksore, rendi i fjalëve dhe përshtatja, fjalia e përbërë me nënrenditje dhe bashkërenditje, ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë. Ndërsa në orët e ushtrimeve studentët do të angazhohen për të ilustruar dijen e fituar për çdo ligjëratë të shpjeguar. Sintaksa e gjuhës shqipe cilësohet si lëndë bosht për përvetësimin e ligjërimit shqip të drejtë, qoftë në formën e shkruar, qoftë në formën e folur.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje:

1. Të identifikojnë përbërësit e fjalisë dhe funksionet e tyre.
2. Do të aftësohen për të folur dhe shkruar gjuhën standarde sipas normave të Sintaksës së shqipes.
3. Duke qenë studentë të gjuhës angleze, me përvetësimin e kësaj lënde pritet që ata të aftësohen edhe për përkthime nga anglishtja në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime, diskutime, punime seminari, detyra shtëpie.

Plani i detajuar

Java e parë: Njohuri të përgjithshme për sistemin sintaksor të gjuhës shqipe

Objekti i sintaksës dhe lidhjet e saj me disiplinat e tjera të gjuhësisë
Njësitë sintaksore
Raportet sintaksore dhe mjetet e shprehjes së tyre

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2- Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.4-11

Java e dytë: Tipat e fjalive të thjeshta në gjuhën shqipe

Kriteret e klasifikimit të fjalive të thjeshta
Tipat e fjalive sipas modalitetit
Tipat e fjalive sipas qëllimit të thënies
Tipat e fjalive sipas ndërtimit (strukturës)
Fjalitë e paplota
Fjalitë e pagjymtyrëzueshme

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.12-25

Java e tretë: Fjalja dykryegjymtyrëshe Gjymtyrët kryesore të fjalisë

Kuptimi i përgjithshëm për fjalinë e thjeshtë me dy gjymtyrë kryesore
Kryefjala
Kallëzuesi
Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.26-34

Java e katërt: Gjymtyrët e dyta të fjalisë

Gjymtyrët e dyta dhe klasifikimi i tyre
Kundrinori
Rrethanori
Gjymtyra e krahasimit
Përcaktori
Ndajshtimi
Përcaktori kallëzuesor

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.34-49

Java e pestë: Rendi i gjymtyrëve në fjali

Njohuri të përgjithshme për rendin e gjymtyrëve
Rendi i gjymtyrëve në fjalinë dëftore

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.50-54

Java e gjashtë:

Vlerësimi i parë intermediar (test provues)

Java e shtatë: Gjymtyrët homogjene

Karakteristikat e gjymtyrëve homogjene
Ndarja e gjymtyrëve homogjene sipas raporteve sintaksore mes tyre
Gjymtyrët homogjene sipas funksionit në fjali
Fjalët përgjithësuese dhe gjymtyrët homogjene

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f. 55-67

Java e tetë:

Gjymtyrët e veçuara, thirrori, fjalët e grupet e fjalëve të ndërmjetme dhe të ndërshtëna

Gjymtyrët e veçuara
Thirrori
Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme
Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërshtëna

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f. 67-76

Java e nëntë: Fjalja e përbërë

Fjalja e përbërë dhe mjetet gjuhësore të ndërtimit të saj
Përbërja dhe skemat strukturore të fjalive të përbëra
Fjalja e përbërë me bashkërenditje
Skemat për fjalitë bashkërenditëse

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.76-86

Java e dhjetë: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur

Fjalë e përbërë me nënrenditje
Fjalë e përbërë kryefjalore
Fjalë e përbërë kallëzuesore
Fjalë e përbërë kundrinore
Fjalë e përbërë përcaktore

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.76-86

Java e njëmbëdhjetë: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur rrethore

Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur vendore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur kohore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur mënyrore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur qëllimore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur shkakore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur kushtore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur lejore
Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore
Skemat për për fjalitë e përbëra me nënrenditje

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f.86-108

Java e dymbëdhjetë: vlerësim i dytë intermediar (test provues)

Java e trembëdhjetë: Fjalitë e ndërmjetme dhe fjalitë e ndërshtëna (të ndërkallura)

Fjalitë e ndërmjetme
Fjalitë e ndërshtëna (të ndërkallura)

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f. 109-112

Java e katërbëdhjetë: Fjalë e përbërë asindetike

Tiparet e fjalisë së përbërë asindetike
Llojet e fjalisë së përbërë asindetike

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa
Prishtinë, 2014, f. 113-116

Java e pesëmbëdhjetë: Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë

Ligjërata e drejtë
Ligjërata e zhdrejtë
Ligjërata e zhdrejtë e lirë

Literatura: N Dako, E Biba, A. Jashari, F. Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2-Sintaksa Prishtinë, 2014, f. 117-125

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i parë: 10%
Vlerësimi i dytë: 10 %
Vlerësimi i tretë: 10 %
Detyrat dhe punimet e seminareve: 10 %
Vijimi i rregullt: 5 %
Provimi final 55 %
Gjithsej: 100 %

Provimi mbahet me shkrim dhe plotësohet me gojë.

Literatura bazë

Niko Dako, Elona Biba, Ali Jashari, Flutura Çitaku, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Prishtinë, 2014

Literatura plotësuese

1. ASHRSH; Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002
2. Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë, 2004
3. Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe-për mësimdhënësit e gjuhës shqipe Prishtinë, 1998
4. M. Çeliku, Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde, Tiranë, 2007
5. T. Kelmendi: Studime sintaksore, Prishtinë, 2008.
6. Vepra të ndryshme letrare për orët e ushtrimeve
7. Të dhëna nga interneti